



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 401 / ProL.
3

Tiranë, më 6 / 4 / 2017

REKOMANDIM

Nr. 09 , datë 6 . 4 2017

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 a/1, dhe 32 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44 datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan,

KONSTATOVA :

Në zbatim të Urdhrit nr. 66 datë 01/03/2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Drejtoria e Uletimit Administrativ kreu hetim administrativ pranë kontrolluesit Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, me objekti kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrit nr. 66 datë 01/03/2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi, Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, është një institucion publik i arsimit të lartë publik, me disa fakultete si Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, Fakulteti Ekonomik, si dhe Fakulteti i Teknologji Informacionit. Kontrolluesi, përpunon të dhëna personale kryesisht për subjektet e dhënave "punëmarrës", "studentë" dhe "vizitorë".

Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale (nëpërmjet dokumentacionit në formatin letër) si dhe në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemeve të teknologjisë së informacionit të tilla si sistemi i video-vëzhgimit (CCTV), portali i studentit, portali zyrtar i institucionit, pajisje kompjuterike etj.

Gjatë hetimit administrativ të ushtruar në vend, është konstatuar se:

1. Kontrolluesi ka "Njoftuar" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, por konstatohet se nuk është deklaruar, kategoria e të dhënave "punëmarrës", qëllimi i përpunimit të të dhënave "imazhe-video" nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), përhapja e të dhënave drejt institucioneve të tjera etj.

2. Kontrolluesi nuk disponon rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Kontrolluesi nuk i ka pajisur punëmarrësit me Deklaratë Konfidencialiteti por kishte parashikuar në rregulloren e përgjithshme kritere mbi ruajtjen e konfidencialitetit.
4. Kontrolluesi mbikëqyr ambientet e brendshme dhe të jashtme nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV). Në ambientet e kontrolluesit janë vendosur tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), por ato nuk janë në përputhje me modelin standard të miratuar me Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit datë 05/03/2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" i ndryshuar. Kontrolluesi monitoron me kamera (CCTV), 10 godina dhe afati i ruajtjes së imazheve video është 30 ditë.
5. Kontrolluesi nuk ka publikuar në portalin zyrtar <http://www.uniuniel.ems.al> "Politikat e Privatësisë", me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në mbrojtje të privatësisë.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i kontrollit hartoi procesverbalin dhe e lexoi në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit, të cilët nuk paraqitën asnjë pretendim por shpjeguan se do të riparojnë menjëherë, të gjitha gjetjet e bëra nga grupi i kontrollit.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", përpara marrjes së vendimit përfundimtar, kontrolluesi Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, është njoftuar zyrtarisht për pjesëmarrje në seancën dëgjimore që do të zhvillohej në datën 31/03/2017, për të ushtruar të drejtën e tij për tu dëgjuar.

Përfaqësuesit e kontrolluesit, në këtë seancë dëgjimore, paraqitën prova me shkrim, të cilat demonstuan rikuperimin e shkeljeve të konstatuara, që konsistojnë në:

1. Përditësimin e "Njoftimit" pranë Zyrës së Komisionerit, në lidhje me përpunimin e të dhënave (në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit).
2. Hartimin e rregullores për "Mbrojtjen e të dhënave personale".
3. Nënshkrimin e Deklaratës së Konfidencialitetit.
4. Kontrolluesi ka nisur tenderimin për prodhimin e tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV). Së shpejti ato do të vendosen në të dhjetë godinat që administron.

Rezulton se Kontrolluesi, Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, përgjithësisht i ka përmbushur detyrimet ligjore me përjashtim të pikave 4 dhe 5 të konstatimeve pra ai ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ dhe ka reaguar në mënyrë të menjëhershme për rikuperimin e shkeljeve.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 5, 6, 30 dhe 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 3 të Komisionerit datë 05/03/2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" i ndryshuar të marrë masa për vendosjen e tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV) në dhjetë godinat që administrojnë.
2. Kontrolluesi Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, të publikojë në portalin zyrtar <http://www.uniuniel.ems.al> "Politikat e Privatësisë", me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në mbrojtje të privatësisë.
3. Kontrolluesi Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të kryejë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikën e parë të këtij Rekomandimi, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 6 / 4 / 2017.

